

Per mardhe
26.06.2026
Gjete




gjuft

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT

DREJTORIA E PËRGJITHSHME RREGULLATORE PËR ARSIMIN
DREJTORIA E LEJEVE, LICENCAVE DHE MONITORIMIT TË SHËRBIMEVE



Nr. 5006/2 Prot.

Tiranë, më 30.06.2026

Lënda: Dërgohet urdhri për njohje dhe zbatim

UNIVERSITETIT "ISMAIL QEMALI", VLORË

Adresa: Skelë, Rruga "Kosova", 9401, Vlorë

QENDRËS SË SHËRBIMEVE ARSIMORE

Adresa: Bulevardi "Zhan D'Ark", Nr. 23, Tiranë

QENDRËS NDËRINSTITUCIONALE TË RRJETIT AKADEMIK SHQIPTAR

Adresa: Rruga e Durrësit Nr. 219, Tiranë

AGJENCISË SË SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

Adresa: Rruga e Durrësit Nr. 219, Tiranë

Bashkëlidhur gjeni për njohje dhe zbatim urdhrin nr. 276, datë 30.06.2026, të Ministrit të Arsimit, "Për hapjen e programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në "Teknik Laboratori", në Universitetin "Ismael Qemali", Vlorë".

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

Erzen Tola





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
MINISTRI

Nr. 5006/1 Prot.

Tiranë, më 30. 06. 2026

URDHËR

NR. 276, DATË 30.06.2026

PËR

**HAPJEN E PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR NË
“TEKNIK LABORATORI”, NË UNIVERSITETIN “ISMAIL QEMALI”, VLORE**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë dhe të neneve 35 dhe 73, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Hapjen e programit të studimit të ciklit të parë “Bachelor” në “Teknik Laboratori”, me 180 kredite dhe kohëzgjatje 3 vite akademike (6 semestra), në gjuhën shqipe, me formë studimi me kohë të plotë, me kod 63BA0914S.
Në përfundim të këtij programi studimi lëshohet diplomë “Bachelor” në “Teknik Laboratori”, në Fakultetin e Shëndetit, në Universitetin “Ismail Qemali”, Vlorë, referuar nivelit 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.
2. Veprimtaria akademike në programin e studimit fillon sipas legjislacionit në fuqi.
3. Institucioni i arsimit të lartë, të marrë masa që programi i studimit t’i nënshtrohet procesit të akreditimit, sipas afateve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.
4. Institucioni i arsimit të lartë, të zbatojë procedurat e aplikimit për regjistrimin e formës së diplomës së këtij programi studimi, pranë institucionit përgjegjës për ofrimin e shërbimeve arsimore dhe të përshtatë aktet e brendshme rregullatore, në zbatim të këtij urdhri.
5. Ministria e Arsimit ushtron kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucionin e arsimit të lartë, në zbatim të këtij urdhri.

6. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore për Arsimin, në Ministrinë e Arsimit, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, institucioni përgjegjës për ofrimin e shërbimeve arsimore dhe Universiteti “Ismail Qemali”, Vlorë.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI
MIRELA KUMBARO-FURXHI





Aurela Saliaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
REKTORI

Vlorë më, . . 2026

Për zbatim :

- **DEKAN FAKULTETIT TË SHËNDETIT**
Prof. Asoc. Enkelejd Mëhilli
- **DEKAN FAKULTETIT TË EKONOMISË**
Prof.Asoc. Florian Miti
- **DEKAN FAKULTETIT TË SHKENCAVE HUMANE**
Prof. Dr. Roland Zisi
- **DEKAN I FAKULTETIT TË SHKENCAVE TEKNIKE DHE NATYRORE**
Prof.Asoc. Miftar Ramosaçaj

REKTOR

Prof. Dr. Aurela SALIAJ



ME URDHËR DHE ME POROSI
ZV/REKTORE PËR MARRDHËNIET ME JASHTË DHE KËRKIMIN SHKENCOR
PRO.ASOC.FROSINA QYRDETI

Frosina Qyrdeti